



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:059115
Datë: 17.11.2021
Numri i dokumentit: 02410910

C.nr.378/20

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Malsor Kryeziu, me zyrtaren ligjore Albana Curri, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit Xh. K. nga fshati . . ., Komuna Gjakovë, të cilin e përfaqëson i autorizuari Nexhmedin Gashi, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e shujtës ditore, vlera e kontestit 736,00 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik të mbajtur me 11.11.2021, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi si e bazuar, kërkesëpadija e paditësit Xh. K. nga fshati . . ., Komuna Gjakovë, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditësit në emër të kompensimit të ushqimit – shujtave për ditët e pranisë në punë, respektivisht për 363 ditë pune, për periudhën kohore 18.04.2017 – 08.04.2019, të ia paguajë shumën prej 726,00 euro (shtatëqind e njëzetë e gjashtë euro), me kamatë ligjore prej prej 8% në vit, e cila do të llogaritet nga data 07.04.2021 (data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 259,00 euro (dyqind pesëdhjetë e nëntë euro), në afatin prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësi në padinë e parashtruar në këtë gjykatë me datë 29.05.2020, përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar se i njëjti ka qenë i punësuar tek e paditura, përkatësisht në SHMFU “Ali Hasi” në fshatin . . ., Komuna Gjakovë, dhe atë deri në arritjen e moshës së pensionimit. Me vendimin e Komunës së Gjakovës, paditësit me datë 08.04.2019 i është ndërprerë kontrata e punës. Kërkesa e paditësit bazohet tek Kontrata Kolektive të Arsimit Parauniversitar e nënshkruar me datë 18.04.2017 nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe SBASHK, përkatësisht neni 35, par. 5 dhe 7, me të cilën është paraparë kompensimi i shujtës ditore. Paditësi prej hyrjes në fuqi të kësaj kontrate datë 18.04.2017 e deri me datë 08.04.2019 kur ka dalë në pension, nuk është kompensuar nga këtu e paditura, pavarësisht faktit se me datë 06.03.2020 i njëjti ka parashtruar kërkesë duke kërkuar nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, që sipas kontratës së lartcekur të i përmbush obligimet, mirëpo e paditura ka refuzuar që paditësin të e kompensojë në raport me shujtën ditore, për çka i njëjti ka qenë i detyruar që të parashtronte padi – kërkesëpadi në këtë gjykatë dhe të kërkojë realizimin e të drejtës së tij subjektive.

I autorizuari i paditësit përgjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se paraprakisht në padi dhe kërkesëpadi i zvogëloje ditët e pranisë në punë të paditësit nga 368 ditë në 363 ditë, e gjithashtu edhe shumën e vlerës nga 736.00 euro në 726.00 euro, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar, në cilësi të provës gjykatës i ka dorëzuar vërtetimin për ditët e pranisë në punë të lëshuar nga SHFMU “Ali M Hasi”, nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës, në dy kopje. Paditësi deri në dalje në pension ka qenë i punësuar në cilësinë e mësimdhënësit tek e paditura. Padia dhe kërkesa mbështeten në dispozita ligjore të kontratës kolektive e nënshkruar nga MASHT dhe SBASHK-u, përkatësisht neni 35 pika 7 ku parashihet që e paditura ka qenë e obliguar të ia paguajë paditësit pagesat për shujtat ditore të pranisë në punë. Pas administrimit të provave do të vërtetohet se padia e paditësit është e bazuar, andaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë si të tillë.

I autorizuari i paditësit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit të provave në këtë çështje kontestimore është vërtetuar padia dhe kërkesa e saj si për nga baza ashtu edhe nga lartësia, duke i propozuar gjykatës që ta aprovojë padinë e paditësit si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë 20.00 euro për taksë gjyqësore, 104.00 euro për përpilimin e padisë, si dhe përfaqësimi në shqyrtimin kryesor, në shumën prej 135.00 euro, gjithsej shumën 259.00 euro, konform tarifës së OAK-së.

Gjykata ia ka proceduar këtu të paditurës aktvendimin e datës 29.06.2020 (*për dhënien e përgjigjes së detyrueshme në padi*) padinë dhe provat materiale, të cilat e njëjta i ka pranuar me datë 15.09.2021 (siç vërtetohet nga fletëkthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës), mirëpo nuk ka parashtruar fare përgjigjen në padi, përkundër obligimit ligjor.

E autorizuar e të paditurës përgjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se konsiderojë se kërkesëpadia që e ka parashtruar paditësi - Xh. K. duhet të konsiderohet si nule pasi që sipas ligjit të punës neni 19 par. 4 thuhet se: “ marrëveshja kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar jo më shumë se 3 vjet”, duke ditur se tani kane kaluar më shumë se 5 vite kërkesëpadia nuk mund të prodhojë efekt juridik sepse është bërë në kohën kur ka kaluar afati ligjor. Po ashtu Komuna e Gjakovës nuk ka të lidhur ndonjë kontratë me personelin arsimor për pagesën e shujtave.

E autorizuar e të paditurës në fjalën përfundimtare ka deklaruar qëndrojë si në deklaratimet e sipër cekura, me propozim që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: vendimin e lëshuar nga Komuna e Gjakovës –DKA 04 nr.87 04-118/01-13315, dt. 25.03.2019, vërtetimin e lëshuar nga SBASHK me dt. 03.07.2019, i nënshkruar nga kryetari Bajram Maliqi, kërkesën e paditësit drejtuar të paditurës me dt. 06.03.2020, vërtetimin e lëshuar nga SHFMU “Ali M Hasi” . . . – Gjakovë, nr. 1326 dt. 23.06.2021, i nënshkruar nga drejtori B.S., me ç’rast pas analizimit të fakteve juridike relevante të kësaj çështjeje, vlerësimi veç e veç të provave dhe lidhshmërinë e tyre reciproke, e në kuptim të nenit 8 të LPK-së, vërtetojë se kërkesëpadia e paditësit, është në tërësi e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga provat e administruara, u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

Me vendimin e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – DKA 04 nr.87 04-118/01-13315, dt. 25.03.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se këtu paditësit i është ndërprerë mardhënia e punës me datë 08.04.2019, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.

Me vërtetimin e lëshuar nga SBASHK, dt. 03.07.2019, i nënshkruar nga kryetari Bajram Maliqi, gjykata ka provuar faktin se i njëjti ka qenë anëtar i sindikatës (deri në pensionim nga këtu e paditura).

Kërkesa e paditësit drejtuar të paditurës me dt. 06.03.2020, vërteton rrethanën se këtu paditësi i drejtuar Komunës së Gjakovës – Drejtorisë së Arsimit, për kompensimin e shujtës ditore, bazuar në kontratën në fuqi.

Nga vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Ali M Hasi” . . . – Gjakovë, nr. 1326 dt. 23.06.2021, i nënshkruar nga drejtori Bajram Salihi, është provuar fakti se paditësi nga data 18.04.2017 e deri me datë 16.06.2017 – ka punuar në institucionin e lartcekur për 363 ditë pune.

Gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar, datë 18.04.2017 me të cilën është paraparë se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim, për t’u bërë kompensimin”* dhe duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk ka argumentuar (me asnjë provë materiale, meqenëse nuk ka parashtruar përgjigje në padi), faktin se e ka të rregulluar çështjen e ushqimit të të punësuarve (në vend punimin – objektin ku ka punuar këtu paditësja), si dhe duke pasur parasysh faktin se nga vërtetimi me nr. 1326 i lëshuar nga SHFMU “Ali M Hasi” . . . – Gjakovë, me datë 23.06.2021, janë vërtetuar ditët e prezencës në punë të paditësit për periudhën kohore të kërkuar nga i njëjti (18.04.2017 - 18.04.2019 –363 ditë pune), rezulton se kërkesa e paditësit për një kompensim të këtillë është e themeltë, ashtu që të njëjtit i takon shuma në lartësi prej 726,00 euro, marrë parasysh dispozitën e lartcekur, për çka edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, është në fuqi dhe e zbatueshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe se ky dokument kontraktual, prodhon efekt juridik ndaj palëve në procedurë të cilat janë të legjitimuara në kuptimin e legjitimitetit real aktiv dhe pasiv në këtë çështje juridike

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditorit, përkatësisht këtu paditësit në rastin konkret, të ia paguajë vlerën e kërkesëpadiisë si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç më detajisht është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatëvonesën gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet se *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit*

në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”, tutje paragrafi 2 i këtij neni parasheh se “Lartësia e kamatëvonesës është 8% në vit, për veç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”, andaj meqenëse e paditura ka rënë në vonesë në kompensimin e obligimit sa i përket kompensimit për pagesën e ushqimit në punë që ka pasur ndaj këtu paditësit , gjykata vlerëson së përpos kërkesës kryesore, të njëjtës i takon edhe kamata e gjykuar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u mor sipas nenit 452 par. 1 të LPK-së, me ç’rast paditësit iu pranuan shpenzimet siç në poshtë vijojnë: për pagesën e taksës gjyqësore për padi, shuma prej 20,00 euro, për përpilimin e padisë shume prej 104,00 euro, dhe për pjesëmarrjen e të autorizuarit të saj në shqyrtimin kryesor, shuma prej 135,00 euro, përkatësisht shuma e përgjithshme prej 259,00 euro.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.378/20, 11.11.2021

Gj y q t a r i
Malsor Kryeziu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën.